



FTESA PER OFERTE

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik
Shëtitorja "Dëshmorët e Kombit", Tirane

Bashkia Tiranë fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Puneve të mëposhtme:

Bashkia e Tiranës ose "**Autoriteti Kontraktor**", fton Operatorët Ekonomikë në një procedure ndërkombëtare tenderimi për Partneritetin Publik Privat për hartimin e detajuar dhe zbatimin e ndërtimit të një terminali të ri të transportit publik, mirëmbajtjen e tij, si dhe menaxhimin e mëvonshëm të terminalit të transportit publik të Tiranës ("**Projekti**"), në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këto dokumente tenderi dhe me kushtet e kontratës .

Vlera e vlerësuar e projektit është **15.477.857,31**(pesëmbëdhjetë million e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqindpesëdhjetë e shtatë presje tridhjetë e një) **Euro** (pa përfshirë TVSH)

Autoriteti Kontraktor do të zbatojë procedurën e hapur të tenderit në pajtim me nenin 22 të ligjit shqiptar të koncesioneve dhe partneritetit public privat nr. 125/2013. Autoriteti kontraktor do të marrëparasysh vetëm ofertat e atyre tenderuesve apo konsorciumet e tenderuesve, të cilët kanë kaluar kufijtë minimalë, të përcaktuara në kriteret e kualifikimit.

Gjatë ndërtimit të terminalit, objektivi i Autoritetit Kontraktor është përmirësimi i lëvizshmërisë së përgjithshme, duke siguruar një terminal me kapacitet të plotë transporti ku autobusët ndërqytetës do të shkarkojnë pasagjerë për në autobusë urbane dhe taksi përgjatë korridorit kryesor të qytetit në pjesën veriore, perëndimore dhe jugore të vendit, duke zvogëluar bllokimet e trafikut në qendër të qytetit, përmirësimin e ndotjes së ajrit dhe reduktimin e konsumit të karburantit për transport publik.

Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një truall prej 85,000 metra katrorë vendosur përgjatë korridorit kryesor që çon në veri-perëndim, nga qyteti në drejtim të Durrësit, truall i cili do t'i kontraktohet në baza afat gjatë Ofertuesit fitues për të ndërtuar, operuar dhe për të ruajtur terminalin për të mirën e operatorëve dhe udhëtarëve. Në shkëmbim, të gjitha tarifat e

vendqendrimin të autobusëve, të ardhurat e qiradhënies me pakicë, dhe tarifatat e parkimit, do të arkëtohen nga Operatori Ekonomik për amortizimin e CAPEX-it të tij fillestar, shpenzimet operative, dhe për mbulimin e shërbimit të borxhit.

Tenderimi për kontratën është i hapur për firmat dhe sipërmarrjet e përbashkëta të firmave e çdo vendi të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara me poshte.

Vendi I kryerjes së kontratës së punës
Rruga e Kastriotëve, Kthesa e Kamzes, Tirane

Afati I ekzekutimit të kontratës Kohëzgjatja e kontratës PPP të Koncensionit do të jetë deri 35 vite.

Oferta duhet të paraqitet Elektronikisht në web site të app-së www.app.gov.al

Përpara

Data e hapjes 27/02/2017, ora 11:00

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të web-it të APP-së, www.app.gov.al.


